

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 191, datë 20.4.2023

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË VITIT SHKOLLOR 2023–2024 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe nenit 7, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJMË:

Struktura e vitit shkollor 2023–2024 të jetë si më poshtë:

1. Në arsimin bazë:

- a) Mësimet fillojnë më 11 shtator 2023 dhe mbarojnë më 14 qershor 2024.
- b) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2023 dhe mbarojnë më 5 janar 2024.
- c) Pushimet fillojnë më 1 prill 2024 dhe mbarojnë më 5 prill 2024.
- ç) Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 17–18 qershor 2024.

2. Në arsimin e mesëm të lartë:

- a) Mësimet fillojnë më 11 shtator 2023 dhe mbarojnë më 14 qershor 2024.
- b) Për maturat, mësimet fillojnë më 11 shtator 2023 dhe mbarojnë më 31 maj 2024.
- c) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2023 dhe mbarojnë më 5 janar 2024.
- ç) Provimet e Maturës Shtetërore zhvillohen në periudhën 3–28 qershor 2024.

3. Në arsimin profesional:

- a) Mësimet fillojnë më 11 shtator 2023.
- b) Nxënësit e klasave të 10-ta për të gjitha strukturat, nxënësit e klasave të 12-ta për strukturën, 2+2, si dhe nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 4-vjeçare mësimet mbarojnë më 14 qershor 2024.
- c) Nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta për strukturën 2+1+1 dhe për nxënësit e klasave të 11-ta për strukturën 2+2 mësimet mbarojnë më 31 maj 2024.
- ç) Për të gjithë nxënësit maturantë, viti shkollor mbaron më 17 maj 2024.
- d) Pushimet fillojnë më 26 dhjetor 2023 dhe mbarojnë më 5 janar 2024.
- dh) Provimet përfundimtare për kualifikimet profesionale të nivelit II dhe III të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) zhvillohen në periudhën 3–14 qershor 2024.
- e) Provimet përfundimtare të praktikës profesionale të kualifikimeve profesionale të nivelit IV të KSHK-së zhvillohen në periudhën 27–31 maj 2024.
- ë) Provimet e Maturës Shtetërore Profesionale zhvillohen në periudhën 3–28 qershor 2024.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe të gjitha institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Evis Kushi

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj